

RELACION

MBI MIRATIMIN E BUXHETITTE VITIT 2017

Të nderuar keshilltare

Po mbyllim një vit të plote kalendarik të aktivitetit të USSH-së që nga krijimi i tij. Gjatë këtij viti është organizuar puna për licensimin e stomatologëve të ardhur nga auditoret, rilicensimin e stomatologëve që kanë mbush afatin kohor të licensimit, si dhe licensimin e ndihmës stomatologëve. Gjithashtu, me krijimin e sektorit të monitorimit, është bërë rikonicionimi i klinikave pothuaj në gjithë qytetet e rajoneve dhe vazhdon në rajonin e Tiranës. Gjatë këtij monitorimi janë evidentuar dhe lënë detyra për mangësitë e vërejtuar për shërbimin stomatologjik, duke ju referuar Statutit dhe Kodit Etik të USSH-së.

Gjithashtu, nga komisioni dhe sektori i licensimit janë punuar për plotësimin e dokumentacionit për dhënien e licencës si dhe për shkurtimin e afatit kohor të dhenies së saj.

Gjithë aktiviteti vjetor i Aparatit Qendror, i drejtuar nga organet vendim marrëse, i shërben realizimit të misionit për të cilën është krijuar Urdhri, për rjedhojë gjenerimit të të ardhurave për realizimin e këtij misioni si dhe administrimin e tyre në mënyrë efektive.

BUXHETI I VITIT 2017

1. Objektivat e Buxhetit 2017

Krijimi i një sistemi për realizimin e të ardhurave nëpërgjithësi dhe të ardhurat nga kuotat mujore në veçanti,

Së pari: Duke rritur bazën e atyre që do të paguajnë së kuotat mujore pamvarësisht licensimit

Së dyti: Krijimi i mundësive të reja për rritjen e tyre.

2. Detajimi i Buxheti për vitin 2017

Hartimi i buxhetit është mbështetur në përvojën e vitit 2016 si për realizimin e të ardhurave, ashtu dhe për përdorimin e shpenzimeve sipas natyrës ekonomike, gjithashtu është mbështetur si në përdorimin e buxhetit në qendër, ashtu edhe nga Rajonet. Buxheti është i detajuar sipas njësive vartëse dhe sipas natyrës ekonomike. Buxheti parashikohet të jetë i balancuar.

2.1 Planifikimi I te ardhurave


Planifikimi I të ardhurave bazohet nga të dhënat që disponojmë si:

- realizimi I të ardhurave për periudhën si dhe I pritshmi deri në fund të vitit 2016,
- nga numri I antarëve të Urdhrit të regjistruar në Regjistrin Kombëtar,
- numri I antarëve të liçensuar dhe të rilicensuar për vitin 2016
- numri I antarëve që kanë dhënë provim dhe janë liçensuar gjatë vitit 2012
- numri I stazhistëve të regjistruar për provimin e dhjetorit 2016
- nga numri I studenteve që mund të perfundojnë studimet në stomatologji dhe që do të futen në provimin e shtetit si dhe
- numri të stomatologeve që mund të rilicensohen.

Të dhënat për planifikimin e të ardhurave për vitin 2017 paraqiten si vijon:

Nr	Emertimi	Plani	Fakti 10 mujor		Plani vitit 2017	
		Vitit 2016	Nr	Shuma ne 000 leke	Nr	Shuma ne 000 leke
	TE ARDHURA GJITHSEJ					
1	Licensime	7500	326	4890	300	4500
2	Rilicensime		199	2970	300	4500
3	Hapje dosje	3000	264	2640	230	2300
4	Kuotat antaresimi	30000	1203	15655	1800	25920
	- Licensime		326	3256	300	2880
	- Rilicensime		199	3914	300	5100
	- Te tjera		678	8475	1200	18000
5	Provimi i praktikës	0	60	600	230	2300
6	Certifikate mirsjellje	500	23	510	24	480
7	Te tjera	0	0	18	0	0
	TOTALI	41000		27.283		40.000

Ecuria e nr te antareve te regjistruar, licensuar dhe qe kane paguar kuotat e antaresimit per vitet 2016-2017 paraqitet grafikisht si vijin:



Te ardhurat nga licensimet janë bazuar nga numri I regjistrimit të studentëve stazhiste për provimin e m. dhjetor 2016 si dhe nga regjistrimet e pritshme për provimet e sezonit të dytë të vitit 2017, korektuar me kalueshmërinë e provimit të shtetit.


Te ardhurat nga rilicensimet janë llogaritur nisur nga numri I Stomatologëve që kanë rezultuar pozitiv në provimin e vitit 2012 si dhe numri i stomatologeve të rilicensuar në vitin 2012.

Te ardhurat nga hapja e dosjeve janë llogaritur nisur nga numri I studentëve që priten të përfundojnë studimet nga universitetet publike apo private, si në sezonin e parë dhe në sezonin e dytë të vitit 2017 .

Te ardhurat nga provimi i praktikës janë të ardhura që për vitin 2016 ishin simbolike. Për vitin 2017 janë llogaritur nisur nga numri i studenteve që përfundojnë studimet dhe që do të behen antare të Urdhrit, sipas zerit më sipër (hapje dosje)

Te ardhurat nga kuotat e antaresimit, për periudhën 10 mujore janë realizuar vetëm 52%, pasi 525 vete kanë paguar si rezultat I licensimit dhe rilicensimit dhe rreth 680 raste kanë paguar rregullisht, pamvarësisht licensimit, kryesisht kuota të vitit 2015, pra rreth 40% e antarëve të Ussh-se. Për vitin 2017 synimi është që të rritet numri I antarëve që paguajnë rregullisht me 50% pra nga 1200 raste në 1800 raste, ose rreth 56% e antarëve të Urdhrit.

Planifikimi I të ardhurave sipas peshës specifike të tyre, paraqitet si vijon:



Për realizimin e të ardhurave kërkohet puna e të gjithë organeve të Urdhrit si atyre të zgjedhur, ashtu dhe atyre të emëruar.

2.2 . SHPENZIMET

Shpenzimet janë planifikuar për mbulimin e aktivitetit të plotë të vitit 2017 për realizimin e misionit të urdhrit për rritjen e nivelit të shërbimit në fushën e stomatologjisë.

Shpenzimet janë planifikuar sipas strukturës ekonomike si dhe sipas njësive administrative

A. *Ndarja sipas strukturës ekonomike, buxheti detajohet si vijon:*


1. **Shpenzimet e personelit** të cilat janë përcaktuar sipas nr. të punonjësve të miratuar në Këshillin Kombëtar dhe pozicioneve të tyre në strukturë. Në këtë zë përfshihen pagat, kontributi I sig. shoqërore e shëndetësore si dhe fondi I veçantë.
2. **Shpenzimet operative** janë llogaritur për funksionimin normal të punës së administratës së Aparatit Qëndror dhe funksionimin e Rajoneve. Në këtë strukturë përfshihen shpenzimet për kanceleri, shtypshkrime, boj për printera, shpenzime për shërbime si energji, uje, telefoni, etj.
3. **Shpenzimet për honorare**, janë shpenzimet përpagesën e sh përblimeve të këshillave Kombëtar e Rajonal si dhe komisioneve të tyre sipas miratimit të masës së shpërblimit nga Këshilli Kombëtar.
4. **Investime për pajisje zyre** janë shpenzime për rikonstruksion të zyrave, blerje mjeti dhe pajisje zyre.
5. **Fondi rezervë**, I cilipërcaktohet deri në 3% të shpenzimeve, I cili planifikohet për shpenzime apo ngjarje të pa parashikuar dhe që mund të ndodhin gjatë vitit.
6. **Shpenzime për Aktivitete shkencore** janë projektet që mund të realizohen për aktivitet shkencor në fushën e stomatologjisë dhe që nuk mund të mbulohen me të ardhurat e vet aktivitetit.

Planifikimi I shpenzimeve paraqitet sipas tabelës:


Në 000 leke

Nr	Emertimi	Plani I vitit 2016	I pritshmi 2016	Shpenzime Aparati Qendror	Shpenzime Rajonet	Totali
1	Paga dhe shperblime	14700	12000	15200	1650	16850
2	Fondi I veçante	730	700	760	80	840
3	Kontribut I sig shoqerore e shendetesore	2520	1800	2600	270	2870
4	Shperblime (honorare)	5900	6100	1160	3900	5060
5	Mallra e sherbime	7800	7335	6350	1800	8150
6	Investime	5700	1900	4300	0	4300
7	Aktivitete shkencore	1150	0	150	780	930
	Shuma	38500	29835	30520	8480	39000
8	Fondi rezerve	1000	0	780	220	1000
	TOTALI	39500	29835	31300	8700	40000

Dhe në mënyrë grafike, shpenzimet paraqiten si vijon:



Dhe sipas peshes specifike te tyre ne menyre grafike paraqiten si vijon:



B. Ndarja sipas njesive administrative, buxheti detajohet si vijon:

Nisur nga detajimi dhe realizimi I buxhetit per vitin 2016 nga Rajonet, per vitin 2017 detajimi do te jete si vijon

Nr	Emertimi	SHUMA ne 000 leke
	SHPENZIME GJITHSEJ	40.000
1	Aparati qendror	31300
2	Keshilli Rajonal Tirane	1830
3	Keshilli Rajonal Durres	1200
4	Keshilli Rajonal Fier	1100
5	Keshilli Rajonal Elbasan	1100
6	Keshilli Rajonal Vlore	1070

7	Keshilli Rajonal Lezhe	1200
8	Keshilli Rajonal Shkoder	1200

Detajimi sipas strukture ekonomike të buxhetit të rajoneve është paraqitur në tabelën më lart. Struktura e shpenzimeve të Rajoneve sipas strukture ekonomike detajohet në paga e honorare për Presidentet e rajoneve, sekretaret e tyre, keshillat rajonal si dhe komisioneve disiplinore.

Në zbatim të Ligjit nr.127/2014 “Për Urdhrit e Stomatologut”, rajonet do të miratojnë detajimin e mëtejshëm të buxhetit në Këshillat e tyre rajonal. Vendimi I miratimit të Buxhetit të vitit 2016 do të depozitohet në Aparatin Qendror për zbatim të Tij.

Buxheti rajonal është vjetor dhe nuk mbartet për vitin tjetër.

Zbatimi I buxhetit do të bëhet sipas legjislacionit financiar në fuqi.

Arkëtimet do të vazhdojnë të bëhen vetëm nëpërmjet sistemit bankar, I vërtetuar me mandat arkëtimin e bankës.

Shpenzimet do të bëhen sipas procedurave të përcaktuara dhe të mbështetur në dokumenta standarte të miratuara për financat dhe për kontabilitetin Ndjekja dhe zbatimi I Buxhetit do të bëhet nga Aparati Qendror I Urdhrit, transfertat bëhen nën siglen e Presidentit të Urdhrit, I cili njihet si person juridik dhe është I regjistruar në organet tatimore. Autorizohet Presidenti I Urdhrit për detajimin e mëtejshëm të fondeve në nivele analitik.

Gjithë dokumentacioni për shpenzimet që do të realizohen do të depozitohet në sektorin Ekonomik për likuidim.

Keto ishin treguesit e buxhetit të vitit 2017,

Ju ftoj për miratimin e Buxhetit të vitit 2017.

P/SEKTORIT EKONOMIK

Natasha DHRAMI

